



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

RAPORT MONITORIMI

MBI PROCEDURËN E HEDHJES SË SHORTIT PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË EMËRIMEVE TË DREJTËSISË

ZHVILLUAR NGA KUVENDI I REPUBLIKES NË DATËN 07.12.2018

Tiranë, dhjetor 2018

Avokati i Popullit, si institucion i pavarur, i parashikuar në Kushtetutë, për mbrojtjen, parandalimin e shkeljes dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të ligjshme të individëve, vlerëson Reformën në Drejtësi, si reformën më të rëndësishme për ecurinë dhe zhvillimin sistemit demokratik në Shqipëri.

Reforma në Drejtësi ka marrë fokus të vecantë në punën e institucionit të Avokatit të Popullit, jo vetëm për shkak të detyrimeve ligjore në përcaktuara në legjislacion, por edhe për shkak të vetë rëndësisë që ka kjo reformë dhe që lidhet drejtpërdrejt me respektimin e të drejtave të njeriut në vend.

Nën këtë përgjegjësi, Avokati i Popullit ka qenë dhe vazhdon të jetë në mbështetje të plotë të zbatimit të Reformës në Drejtësi, si një reformë jetike për të gjithë shqiptarët, pasi shumë nga çështjet që adresohen nga qytetarët, lidhen me sistemin e drejtësisë në vend, për shkak të një sërë problematikash që rëndojnë këtë sistem. Për më tepër Avokati i Popullit e konsideron si jetësor për të gjithë shoqërinë shqiptare kthimin e besimit në sistemin e drejtësisë në vend dhe për këtë ka dhënë kontributin e tij në monitorimin e shumë prej proceseve të realizuara në kuadër të Reformës në Drejtësi.

Në vijim po paraqesim raportin e monitorimit për procedurën e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të zhvilluar në datën 7.12.2018, në mjediset e Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

1. Kompetenca e Avokatit të Popullit, për monitorimin e procedurës së shortit, për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Ky raport është hartuar në ushtrim të kompetencës që lidhet pikërisht me monitorimin e procedurës së hedhjes së shortit, për përzgjedhjen e anëtarëve të KED-së, që në këtë rast është kryer nga ana e Kryetarit të Kuvendit.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, parashikon në pikën 3, të nenit 149/d, dhe në pikën 11 të nenit 179 (dispozitat kalimtare dhe të fundit), përkatësisht dhe ndër të tjera se:

“Presidenti i Republikës përzgjedh me short, midis datave 1 dhe 5 Dhjetor të çdo viti kalendarik, anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED)¹... Nëse Presidenti i Republikës nuk arrin të zgjedhë anëtarët deri në datën 5 Dhjetor, Kryetari i Kuvendit i zgjedh ata me short brenda datës 10 Dhjetor të atij viti kalendarik. Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në procedurën e hedhjes së shortit, si dhe në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.

“Presidenti i Republikës, brenda pesë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, zgjedh me short anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, sipas nenit 149/d, pika 3, të Kushtetutës. Nëse Presidenti i Republikës nuk i përzgjedh anëtarët brenda pesë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Kryetari i Kuvendit i zgjedh ata me short brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji...”

¹ Sipas nenit 149/d, pika 1, të Kushtetutës përcaktohet se: “Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrton dhe rendit kandidatët sipas meritës profesionale. Renditja e kandidatëve nuk është e detyrueshme, me përjashtim të rastit kur nuk arrihet të emërohet kandidati”.

Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në procedurën e shortit, si dhe në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.

Gjithashtu në pikën 6, të nenit 284, të ligjit nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, parashikohet se:

“Presidenti i Republikës organizon shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Drejtësi pa vonesë. Procedurat e shortit dokumentohen nga Presidenti i Republikës. Procedurat e shortit zhvillohen në prani të Avokatit të Popullit, i cili harton dhe bën publik një raport monitorimi mbi procedurën e shortit”.

Në përputhje me nenin 149/d, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.

Ky organ shumë i rëndësishëm, përbëhet nga 9 anëtarë të përzgjedhur me short, nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilët plotësojnë kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 221/1, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Ata ushtrojnë detyrën me një mandat një vjeçar, që fillon në datën 1 Janar të çdo viti kalendarik.

Ndërkohë sipas nenit 220, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, përbërja prej 9 anëtarësh e KED-së është:

Dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese,
Një gjyqtar i Gjykatës së Lartë,
Një prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme,
Dy gjyqtarë nga gjykatat e apelit,
Dy prokurorë nga zyrat e prokurorisë, pranë gjykatave të apelit,
Një gjyqtar nga gjykatat administrative.

Sipas pikës 3, të nenit 220, dhe sipas pikës 7, të nenit 221, të po të njëjtit ligj, krahas anëtarëve të KED-së, zgjidhen edhe anëtarë zëvendësues të tyre, që zëvendësojnë të parët në rast pamundësie ose të konfliktit të interesit.

Sipas njoftimit zyrtar që Kuvendi u ka derguar disa institucioneve dhe njoftimit publik të botuar në faqen zyrtare të Kuvendit, cilësohet se, procedura do të zhvillohet në datën 07.12.2018 dhe do të ishte për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Sikurse është sqaruar më sipër, në pjesën që lidhet me qartësimin e kompetencave të Avokatit të Popullit në këtë proces, kompetenca parësore kushtetuese dhe ligjore për zhvillimin e procesit të hedhjes së shortit, midis datave 1 dhe 5 Dhjetor të çdo viti kalendarik, të anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i takon Presidentit të Republikës. Për këtë procedurë, Presidenti i Republikës duhet të miratojë dhe rregulloren e hedhjes së shortit mbi bazën e parimeve të transparencës, gjurmueshmërisë dhe monitorimit të procesit (neni 221, pika 9, i ligjit 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”).

Nëse Presidenti i Republikës nuk arrin të zgjedhë anëtarët deri në datën 5 Dhjetor, Kryetari i Kuvendit i zgjedh ata me short brenda datës 10 Dhjetor të atij viti kalendarik.

Nga ana e Kuvendit gjatë procedurës së hedhjes së shortit u informuam se ndodhemi pikërisht para këtij rasti, pra kur për shkak të pamundësisë së zgjedhjes së anëtarëve nga ana e Presidentit të Republikës, ligji ia delegon të drejtën Kryetarit të Kuvendit, për të zgjedhur me short anëtarët e KED-së.

Në shkresën nr. prot. 3479, datë 21.11.2018 të Presidentit të Republikës, drejtuar Kryetarit të Kuvendit, me lëndën “Mbi organizimin e shortit për përzgjedhjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi që do të funksionojë për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2019”, mbahet qëndrimi se: Kuvendi rezulton se gjatë hedhjes së shortit në 7 Dhjetor 2017, nëpërmjet interpretimit ka përdorur dispozitat tranzitore të nenit 284 të ligjit 115/2016, por duke zgjedhur organin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Duke qenë se Presidenti i Republikës, është ndodhur përpara një situatë ekstra ligjore, është në pamundësi të ushtrimit të kompetencave të tij kushtetuese dhe ai vlerëson se i takon Kuvendit të Shqipërisë, të realizojë procesin e hedhjes së shortit për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në frymën e Kushtetutës duke qenë se ndër të tjera është pikërisht Kuvendi, organi që ka edhe të drejtën e interpretimit autentik të Kushtetutës.

Në vazhdim, Kushtetuta dhe ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i japin diskrecion Presidentit të Republikës, apo në rast tjetër, Kryetarit të Kuvendit, për të përcaktuar rregullat e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Kuvendi, na rezulton se Kryetari i Kuvendit ka nxjerrë një akt diskrecial dhe pikërisht Urdhërin me nr.2 datë 03.12.2018 “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.² Ky urdhër në pikën 22 të tij, ka shfuqizuar Urdhërin nr. 1 datë 22.11.2017 “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, të Kuvendit. Pavaresisht se ligji nuk përcakton shprehimisht (si në rastin e Presidentit të Republikës) detyrimin e Kryetarit të Kuvendit për të miratuar një rregullore për procedurën e hedhjes së shortit, Avokati i Popullit vlerëson se miratimi i një rregulloreje të tillë është i nevojshëm. Në cdo rast kjo rregullore duhet t’u përmbahet parimeve të transparencës, gjurmueshmërisë dhe monitorimit të procesit që janë elemente të rëndësishme dhe thelbësore për të realizuar këtë short.

Ashtu sikundër është parashtruar edhe në raportin e datës 07.12.2017 të institucionit të Avokatit të Popullit, për hedhjen e shortit të datës 07.12.2017, edhe për shortin e organizuar në dhjetor të vitit 2018 asnjë prej këtyre materialeve nuk na janë vënë në dispozicion përpara procedurës së

² Ky Urdhër është publikuar në Fletoren Zyrtare nr.171 datë 04.12.2018.

hedhjes së shortit. Gjithashtu nuk rezulton të jetë marrë në shqyrtim dhe në vlerësim raporti i mësipërm i Avokatit të Popullit dhe madje as të jenë adresuar problematikat e konstatuara dhe të paraqitura aty. Avokati i Popullit vlerëson se pjesëmarrja dhe monitorimi i këtij procesi dhe për më tepër vlerësimi i raporteve të monitorimit duhet të konsiderohen si pjesë e sistemit të “check and balance” dhe të trajtohen problematikat, nëse ka, në kuadër të veprimtarisë të organeve të tjera në vijimsi. Në asnjë rast parashikimet kushtetuese apo ligjore nuk mund të interpretohen në një mënyrë që ti lerë këto dispozita pa veprim, kuptim apo qëllim, por e kundërta. Në vlerësimin tonë, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk bën dallime në lidhje me emërtimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Të dy dispozitat kushtetuese që flasin në lidhje me këtë çështje, si neni 149/d, ashtu dhe neni 179, pika 11, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përdorin të njëjtin emërtim, dhe pikërisht emërtimin Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Dallimet bëhen nga ligji 115/2016, i cili parashikon shprehimisht në nenin 284, termin “Këshilli i Përkohshëm i Emërimeve në Drejtësi”, duke përcaktuar atë si Këshilli i parë që do të zgjidhej me hyrjen në fuqi të Kushtetutës (dhe/ose paketës së ligjeve që do të rregullonin çështjet e reformës).

Dallimi midis të dyve lidhet me një pjesë të procedurës së përzgjedhjes së anëtarëve (gjegjësisht institucionet/organet që duhet të identifikojnë nga çdo grupim gjyqtarësh që përfaqësohet në organ, ata të cilët përmbushin kriteret e legjislacionit në fuqi) dhe afatit të kohëzgjatjes në detyrë, që për Këshillin e Përkohshëm të Emërimeve në Drejtësi, mund të jetë edhe me pak se 12 muaj kalendarik.

Pra, neni 179, pika 11 e Kushtetutes dhe neni 284, pika 6, e ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, normojnë e përcaktojnë procedura të hollësishme për organizimin e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të parë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, si një procedurë përjashtimore dhe jo për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Ndërkohë gjejmë me vend të theksojmë se, kriteret që duhet të përmbushin personat që do ti nënshtrohen shortit janë të njëjta për të dy rastet, por në rastin e parë nuk është parashikuar procedurë ankimi/e drejte ankimi, për personat e përjashtuar nga lista.

Pyetjet që lindin janë: Cili organ ka marrë në këtë proces, atributet e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kur këto organe nuk janë krijuar ende, dhe ku bazohet ligjërisht marrja e këtyre attributeve? Sa kriteret janë vlerësuar se përmbushin kandidaturat përkatëse të paraqitura nga ana e Gjykatës Kushtetuese dhe kandidatët magjistratë, që duhej të verifikoheshin nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë? A janë njoftuar personat e papërfshirë në listat e dërguara Kuvendit dhe cili ka qënë qëndrimi i tyre në lidhje me mospërfshirjen në listë?

Në konkluzion të kësaj pike jemi të mendimit se ndodhemi përpara mungesës së parashikimit ligjor për një rast të tillë, çka krijon premisë për ta bërë të diskutueshëm procesin.

Duket se për të mënjeluar pikërisht këtë fakt, Presidenti i Republikës ka deklaruar për herë të dytë se ishte në pamundësi për të zhvilluar procesin e shortit duke i hapur rrugë Kuvendit për të bërë një gjë të tillë. Rezulton se, Kryetari i Kuvendit nuk e ka pasur të njëjtin qëndrim në lidhje

me nevojën për një interpretim autentik të Kushtetutës për këtë rast dhe ka proceduar me organizimin e procedurës së shortit, sipas Urdhrit nr. 1 datë 22.11.2018 “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.

Gjithashtu një çështje që u diskutua nga palët prezente gjatë procesit të hedhjes së shortit, ishte edhe ajo e emërtesës së organit që do të zgjidhej (Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, apo Këshilli i Përkohshëm i Emërimeve në Drejtësi)^{1,3} Apo e thënë ndryshe: A mund të përdoren dispozitat që Kushtetua dhe ligji kanë parashikuar për zgjedhjen e Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Drejtësi si dispozita përjashtimore edhe për zgjedhjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Në vlerësimin tonë, nëse bëhet fjalë për zgjedhjen e anëtarëve për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, referimi duhet të jetë në nenin 221, pika 3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ku thuhet se: *“Jo më vonë se data 15 Nëntor e çdo viti kalendarik, Gjykata Kushtetuese, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë verifikojnë nëse kandidatët për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni dhe i paraqesin Presidentit të Republikës dhe Kuvendit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet”*.

Një çështje tjetër që vlen të trajtohet është ajo e plotësimit të kriterëve nga kandidatët që do t'i nënshtroheshin shortit. Neni 221, pika 1, e ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, përcakton tetë kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët.

- Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në shkresën nr. 3427/1, datë 04.12.2018, me objekt: “Kthim Përgjigje”, drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, përcjell dy lista: njëra listë përmban emrat e gjyqtarëve të cilët plotësojnë kushtet dhe kriteret sipas nenit 221, të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ndërsa lista tjetër përmban emrat e gjyqtarëve që plotësojnë kushtet sipas nenit 149/d, paragrafi 3, pra vetëm kriteri i masës disiplinore.
- Prokurori i Përgjithshëm nëpërmjet shkresës nr. 3054, datë 14.11.2018, dërgon listën e prokurorëve që plotësojnë kushtet për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në përputhje me nenin 284, pikat 1,2,3 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe gjithashtu dhe listën me emrat e prokurorëve që i plotësojnë të gjitha kushtet e tjera, përveç kushtit për përfundimin e Shkollës së Magjistraturës me arsyetimin që Prokuroria e Përgjithshme të jetë në koherencë të plotë me praktikën e institucioneve të tjera.

³ Kujtojmë se Kushtetuta në terminologjinë e përdorur parashikon vetëm Këshill të Emërimeve në Drejtësi dhe jo Këshill të Përkohshëm të Emërimeve në Drejtësi. Emërtesa Këshill i Përkohshëm i Emërimeve në Drejtësi është vetëm në ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ku neni 284 i këtij ligji parashikon procedurat e propozimit dhe zgjedhjes në këtë organ.

- Kryetari i Gjykatës së Lartë nëpërmjet shkresës nr. 3982 date 13.11.2018 ka dërguar listen me anëtarët e gjykatës së lartë që plotësojnë pjesërisht kushtet e nenit 221 (nuk plotësojnë vetëm kriterin e nenin 221/1 d) dhe nuk ka përfshirë në listë një anëtar që nuk plotëson 2 kritere të nenit 221, e konkretisht pika 1 a, dhe 1 d. Plotësimi strikt i kushteve sipas nenit 221 të ligjit të mësipërm do të linte Gjykatën e Lartë pa përfaqësim në KED.

Pavarësisht se në vlerësimin tonë kriteret e parashikuara nga ligji 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë për kandidatët për anëtarë të KED përjashtojnë një kategori mjaft të madhe gjyqtarësh dhe prokurorësh nga e drejta për të qënë kandidatë për t’u zgjedhur në KED, ato duhen zbatuar në mënyrë rigoroze nga institucionet përkatëse, përse janë kritere të parashikuara në ligj, çka nga shembulli i përmendur më sipër nuk rezulton të jetë bërë.

Siç përmendëm më sipër, në listën e kritereve që parashikon pika 1 e këtij neni, radhiten tetë kritere kumulative që duhen plotësuar nga kandidatët për anëtarë të KED, në momentin e hedhjes së shortit dhe jo vetëm një. Një parashikim të tillë pa ekuivok përmban paragrafi 2 i nenit 221, i ligjit 115/2016, i cili parashikon shprehimisht se: *“kandidatet që nuk plotësojnë një nga këto kushte përjashtohen nga shorti”*.

Këto kritere duhet të plotësohen në të njëjtën mënyrë për të tërë kandidatët pavarësisht kategorisë së sistemit gjyqësor që ata përfaqësojnë, thënë ndryshe të njëjtat kritere duhet të zbatohen si për kandidatët e ardhur nga Gjykata e Lartë ashtu edhe për ata të ardhur nga Prokuria e Përgjithshme, gjykatat e apelit, prokuroritë e apelit dhe gjykatat administrative. Kriteret të ndryshme përcaktohen nga ligji për përfaqësimin në KED të antëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Në këto kushte dhe duke qenë se këto mangësi/problematika/ nuk kanë qenë të identifikuar për herë të parë mendojmë se do të duhej që rregullorja e hedhjes së shortit të përcaktonte këta elemente për të bërë të mundur adresimin e problematikave. Avokati i Popullit vlerëson se nëse të njëjtat kritere që janë zbatuar për të përzgjedhur listën e ardhur nga prokuria e përgjithshme dhe ose atë të ardhur për prokuroritë e apelit, Gjykata e Lartë do të mbetej pa përfaqësim duke qenë se asnjë prej anëtarëve të saj nuk i plotësojnë krejt kriteret e ligjit. Në të njëjtën kohë nëse do të zbatoheshin kriteret me të cilat është pranuar lista e dërguar nga Gjykata e Lartë atëherë në short për kandidatët e Prokurorisë së Përgjithshme dhe atyre të Apelit do të kishim shumë më tepër kandidatë dhe do të kishim edhe anëtarë zëvendësues nga këto kategori çka aktualisht nuk ka ndodhur.

Mendojmë se do të ishte me vlerë krijimi i një instrumenti për analizimin dhe verifikimin paraprak të listave të dërguara nga ana e institucioneve përkatëse në Kuvend, për këtë proces i cili është i domosdoshëm në rastet kur i njëjti institucion dërgon më shumë se një listë me persona për t’u përfshirë në short, apo nëse paraqiten raste që qartas trajtojnë një situatë konflikti interesi që momentin e parë të hedhjes së shortit sic është fakti i paraqitur në shkresën e dërguar nga Kryetari i Gjykatës së Lartë në lidhje me anëtarët e gjykatës së lartë të cilët kanë kandiduar vetë për pozicionet e hapura në Gjykatë Kushtetuese.

Këto çështje do të duhet të ishin adresuar në gjykimin tonë në një nga mënyrat e mëposhtme: marrja e iniciativës për të përmirësuar parashikimet ligjore duke prezantuar amendamente përkatëse, diskutimi i problematikës në Këshillin e Legjislacionit dhe trajtimi i zgjidhjeve, dhe/ose adresimi i çështjes në urdhërin procedural për rregulloren e shortit të miratuar nga Kryetari i Kuvendit.

Nga ana tjetër, gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk u adresua fakti që Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Prokurorja e Përgjithshme të kishin sjellë 2 lista të mundshme për tu hedhur në short dhe as se për çfarë arsye u përzgjedh një nga listat e paraqitura nga këto organe e konkretisht lista që parashikonte plotësimin strikt të të tërë kritereve të nenit 221 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Po kështu një konstatim tjetër i yni është se ligji parashikon masat që merren kur institucionet nuk dërgojnë fare listën e kandidatëve, por jo për rastet kur lista është dërguar, por jo në përputhje me ligjin.

Avokati i Popullit ka kompetenca të caktuara në këtë proces, të parashikuara shprehimisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si dhe nga Ligji nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, sa i takon:

- Monitorimit (vëzhgimit) të procedurës së hedhjes së shortit, për përzgjedhjen e anëtarëve të KED-së, nga ana e Presidentit të Republikës, duke hartuar dhe bërë publik një raport mbi monitorimin e kryer nga ana e tij.
- Pjesëmarrjes si vëzhgues në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (pas krijimit të tij).

Në këtë këndvështrim, bazuar në parashikimet ligjore të ushtrimit të kompetencave të institucionit të Avokatit të Popullit, ky raport monitorimi përmban në vetvete si monitorimin e hedhjes së shortit, problematikat e evidentuara që në fillimet e procesit të të gjithë procedurës së këtij shorti, po kështu dhe rekomandimet përkatëse ku mund të përmirësohet më tej ky proces.

Për këtë arsye, ripërsërisht rekomandimin tonë të bërë edhe në raportin e vitit 2017 për të bërë amendimet përkatëse në legjislacion për të bërë të mundur zbatimin efektiv të frymës së ligjit, për metodologjinë e përzgjedhjes së këtyre organeve. Qëndrimet e ndryshme interpretative në lidhje me këtë aspekt, fatkeqësisht çojnë në krijimin e debateve që në gjykimin e Avokatit të Popullit ulin potencialisht besimin e publikut në këtë proces përzgjedhjeje në vecanti dhe në aplikimin e reformës në drejtësi, në përgjithësi. Krijimi i besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe dhënia e drejtësisë në Shqipëri janë qëllime madhore, të cilat duhet të vlerësohen si kryefjalë nga çdo organ kushtetues, në ushtrimin e çdo kompetence nga ana e tyre.

Nga ana tjetër, si institucion i ngarkuar nga Kushtetuta dhe nga ligji 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, për shkak të rëndësisë dhe transparencës së këtij procesi, rekomandojmë që dokumentat të cilat janë pjesë përbërëse e procedurës, të vihen në dispozicion paraprakisht të institucionit të Avokatit të Popullit, dhe personave të tjerë të ftuar në prani të të cilëve do të hidhet shorti sic është përcaktuar në urdhrin e Kryetarit të Kuvendit përpara kryerjes

së procesit, si një dëshmi dhe vlerësim serioz i kësaj hallke të zinxhirit të reformës në drejtësi, i cili monitoron dhe rekomandon me rigozitet dhe përgjegjshmëri këtë detyrim që i ka ngarkuar ligji. Në rast se Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, gjykon se publikimi në faqen zyrtare të dokumentacionit plotëson kushtin e transparencës të zhvillimit të këtij procesi, vlerësojmë se njoftimi i shpalljes për zhvillimin e shortit duhet të përmbante të paktën njoftimin se ku mund të gjendeshin (linku i faqes online) dokumentat mbi bazën e të cilave po hidhej shorti dhe të gjitha detajet dhe dokumentacionin e përcjellë nga institucionet e ngarkuara nga ligji 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, sipas listave përkatëse të dërguara. Mungesa e këtij publikimi të detajuar si një element thelbësor i procesit, është një domosdoshmëri për të cilën Avokati i Popullit, rekomandon plotësimin e saj për garantimin e ligjshmërisë, transparencës, seriozitetit dhe besimit në proces.

Parimet e transparencës, gjurmueshmërisë dhe monitorimit të procesit të përcaktuara në pikën 9 të nenit 221 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, duhet të jenë efektive për të bërë të mundur si përcaktimin e kandidatëve të cilët do të nënshtrohen shortimit ashtu edhe procedurën e shortimit të kandidatëve për t’u bërë anëtarë. Thënë ndryshe, shortim nuk mund të konsiderohet vetë procedura e nxjerrjes nga kutitë e emrave fitues, por edhe ajo e futjes në kuti të emrave që plotësojnë në mënyrë korrekte kriteret e përcaktuara në ligj.

Monitorimi i hedhjes së shortit

Në njoftimin përkatës drejtuar Avokatit të Popullit, me shkresën nr. 3817/3 prot., datë 04.12.2018, nga ana e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, është kërkuar pjesëmarrja në hedhjen e shortit për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, datë 7.12.2018, ora 10.00, proces ky i zhvilluar në ambientet e Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Ky njoftim, nga ana e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, është bazuar në pikën 3, të nenit 149/d të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 284, të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”.

Procesi u drejtua nga ana e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, z. Gramoz Ruçi.

Pas hapjes formale të procesit nga ana e Kryetarit dhe disa sqarimeve të dhëna prej tij, nga verifimi i kryer prej Sekretariatit Teknik të krijuar për këtë proces nga Kryetari i Kuvendit, ka rezultuar se, kanë qënë pjesëmarrës për të ndjekur këtë procedurë të hedhjes së shortit, në ambientet e Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, përfaqësues nga Gjykata Kushtetuese; përfaqësues nga Gjykata e Lartë; përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme; Avokati i Popullit dhe përfaqësues nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Në zhvillim të procesit kanë qënë të pranishëm edhe përfaqësues të grupeve parlamentare (Partia Demokratike - z. Oerd Bylykbashi, Partia Socialiste – z. Ulsi Manja; përfaqësues të përfaqësive të huaja diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë, përfaqësues të organizatave partnere ndërkombëtare në cilësinë e vëzhguesve, si dhe media. Konstatohet se, nga institucionet përkatëse që janë ftuar të marrin pjesë në hedhjen e shortit, institucioni i Avokatit të Popullit ka

qënë i vetmi institucion shtetëror që është përfaqësuar në nivel titullari, ndërkohë që institucionet e tjera kanë sjellë përfaqësues të niveleve më të ulëta.

Pas kësaj, z. Bylykbashi, përfaqësues i Partisë Demokratike ka kërkuar fjalën për t'u shprehur për qëndrimin e Partisë Demokratike mbi procedurën e hedhjes së këtij shorti. Duke parashtruar argumente të ndryshme për kundërshtimin e zhvillimit të hedhjes së shortit në këto rrethana, ai ka theksuar qëndrimin e grupit parlamentar të Partisë Demokratike, për moszhvillimin e kësaj procedure, duke e konsideruar antikushtetuese, duke u bazuar dhe në faktin që Presidenti i Republikës, ka vlerësuar se dhe për këtë vit Kuvendi është i vetmi organ që ka mundësinë dhe detyrimin për ta zgjidhur këtë situatë, për shkak të vakuimit ligjor i cili duhej ta çonte Kuvendin e Republikës së Shqipërisë në një reflektim për një zgjidhje ligjore.

Në vazhdim Z. Ruçi, vijoi me organizmin e shortit duke argumentuar se mbledhja e sotme ishte pikërisht për zhvillimin e shortit në zbatim të Kushtetutës dhe legjislacionit në fuqi.

Pas debatesh të tjera në vazhdim, është kaluar në zhvillimin e procesit për hedhjen e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Për hedhjen e shortit ishte krijuar një Sekretari Teknike, e caktuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, me përbërje të nëpunësve civilë të këtij institucioni. Për këtë procedurë ishin të vendosura dy kuti transparente, ku në njërin prej kutive ishin të vendosura vendosura goglat dhe ndërkohë në kutinë tjetër me mekanizëm rrotullues (e cila fillimisht ishte bosh), vendoseshin goglat në të cilat ishin futur shiritat e letrës të shënuara me emrat e kandidatëve të propozuar nga secili institucion, sipas listës përkatëse të përcjellë Kuvendit të Shqipërisë, prej tyre. Fillimisht shiritat e letrës me emrat e kandidatëve sipas institucioneve përkatëse që marrin pjesë në short, ishin vendosur në një kuti transparente të veçantë.

Shiritat e letrës me emrat e kandidatëve pasi u lexuan publikisht edhe në praninë e mediave u futen në gogla dhe rradha e hedhjes së shortit u përcaktua duke u mbështetur në renditjen e mëposhtme:

- Kandidatë nga Gjykata Kushtetuese
- Kandidatë nga Gjykata e Lartë;
- Kandidatë nga Prokuroria e Përgjithshme;
- Kandidatë nga Gjykatat e Apelit;
- Kandidatë nga zyrat e prokurorisë pranë gjykatave të apelit;
- Kandidatë nga gjykatat administrative.

1. Procedura e zhvillimit të shortit për përzgjedhjen e kandidatëve nga Gjykata Kushtetuese nuk u zhvilluan për shkak se nga Gjykata Kushtetuese janë dërguar vetëm dy emra, të cilët automatikisht u konsideruan anëtarë të këtij Këshilli. Konkretisht, nga Gjykata Kushtetuese u përzgjedhën gjyqtarët: Bashkim Dedja dhe Vitore Tusha.

Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve zëvendësues, procedura nuk u zhvillua për shkak se nuk ishte përcjellë asnjë emër për pozicionet përkatëse.

2. Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve nga Gjykata e Lartë (3 kandidatë sipas listës përkatëse), përfaqësuesi i Gjykatës së Lartë pasi bëri përzierjen e goglave, në mënyrë rastësore tërhoqi emrin e një kandidati dhe e lexon me zë të lartë duke ja vënë në dukje Sekretariatit Teknik dhe të gjithë përfaqësuesve pjesëmarrës emrat.

Konkretisht, nga Gjykata e Lartë u përzgjedh gjyqtari: Ardian Dvorani.

Shiriti i letrës që gjendej brenda goglës së përzgjedhur, ju dorëzua Sekretariatit Teknik. Kandidati, i mësipërm do të jetë anëtar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Me të njëjtin short dhe të njëjtën procedurë, u zgjodh edhe një anëtar zëvendësues nga Gjykata e Lartë sipas parashikimeve të pikës 7, të nenit 221 të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, dhe konkretisht gjyqtari Mehdi Bici.

3. Procedura e hedhjes së shortit për përzgjedhjen e kandidatëve nga Prokuroria e Përgjithshme nuk u zhvillua për shkak se nga Prokuroria e Përgjithshme ishte dërguar vetëm një emër, i cili “*ipso-jure*” u konsiderua anëtar i këtij këshilli pa nevojën për hedhjen e shortit përkatës. Konkretisht, u caktua emri i prokurores Arta Marku.

Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve zëvendësues, procedura nuk u zhvillua pasi nuk kishte prokurorë të tjerë që plotësonin kriteret.

4. Procedura e zhvillimit të shortit për përzgjedhjen e kandidatëve nga Prokuroria panë Gjykatave të Apelit nuk u zhvilluan për shkak se nga ky institucion ishte dërguar vetëm një emër, aq sa është edhe numri i vendeve për këtë këshill, i cilët “*ipso-jure*” u konsiderua anëtar i këtij këshilli pa nevojën për hedhjen e shortit përkatës. Konkretisht, u caktua emri i prokurores Fatjona Memçaj.

Lidhur me procedurën e shortit për përzgjedhjen e kandidatëve zëvendësues, procedura nuk u zhvillua për shkak se nuk ishte përcjellë asnjë emër për pozicionet përkatëse.

5. Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e anëtarëve nga Gjykatat e Apelit, ku lista e gjyqtarëve përmbante 14 emra. Pasi u bë përzierja e goglave, në mënyrë rastësore u tërhoqën emrat e dy kandidatëve të cilat u lexuan me zë të lartë duke ja vënë në dukje Sekretariatit Teknik dhe të gjithë përfaqësuesve pjesëmarrës emrat.

Konkretisht, nga Gjykatat e Apelit u përzgjedhën gjyqtarët: Fatri Islamaj dhe Margarita Buhali.

Kandidatët, e mësipërm do të jetë anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Lidhur me procedurën e shortit për përzgjedhjen e kandidatëve zëvendësues, Sekretariati Teknik tërhoqi goglen e cila në brendi të saj mbante shiritin me emrin e gjyqtarit Gurali Brahimllari.

6. Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e anëtarëve nga Gjykatat Administrative (16 kandidatë). Pasi u bë përzierja e goglave, në mënyrë rastësore u tërhoqën emrat e dy kandidatëve të cilat u lexuan me zë të lartë duke ja vënë në dukje Sekretariatit Teknik dhe të gjithë përfaqësuesve pjesëmarrës emrat.

Konkretisht, nga Gjykatat e Administrative u përzgjedh gjyqtari Erjol Roshi Shiriti i letrës që gjendej brenda goglës së përzgjedhur, ju dorëzua Sekretariatit Teknik. Kandidati, i mësipërm do të jetë anëtar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Me të njëjtin short dhe të njëjtën procedurë, u zgjodh edhe një anëtar zëvendësues nga Gjykatat e Apelit dhe ato Administrative sipas parashikimeve të pikës 7, të nenit 221 të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, dhe konkretisht gjyqtari Klodiana Veizi (Mema).

Në përfundim të këtij procesi, u përzgjedhën në total 8 anëtarë të Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Sistemin e Drejtësisë dhe 3 anëtarë zëvendësues, si dhe rezultatet e shortit dhe procedurat e hedhjes së shortit u regjistruan në audio dhe video përkatëse. Përfundimisht, në përfundim të hedhjes së shortit, Kryetari i Kuvendit Z.Gramoz Ruçi, shpalli emrat e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të Përkohshëm), të përzgjedhur nga shorti, si dhe emrat e anëtarëve zëvendësues, si vijon:

Anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi:

- | | |
|---------------------|---|
| 1. Vitore Tusha | Gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese |
| 2. Bashkim Dedja | Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese |
| 3. Ardian Dvorani | Gjyqtar i Gjykatës së Lartë |
| 4. Arta Marku | Prokurore nga Prokuroria e Përgjithshme |
| 5. Fatri Islamaj | Gjyqtar nga gjykatat e apelit |
| 6. Margarita Buhali | Gjyqtare nga gjykatat e apelit |
| 7. Fatjona Memçaj | Prokurore pranë gjykatave të apelit |
| 8. Eriol Roshi | Gjyqtar nga gjykatat administrative |

Anëtarë zëvendësues të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

- | | |
|--------------------------|--------------------------------------|
| 1. Medi Bici | Gjyqtar i Gjykatës së Lartë |
| 2. Gurali Brahimllari | Gjyqtar nga gjykatat e apelit |
| 3. Klodiana Veizi (Mema) | Gjyqtare nga gjykatat administrative |

AVOKATI I POPULLIT

ERINDA BALLANCA